

DISKUTIM mbi temën : “Shqipëria: Rruga drejt një zhvillimi të qëndrueshëm”.

Z. Sybi Hida, Drejtori i Sektorit të Analizave Fiskale, Politikat Buxhetore dhe Sektori Investimeve, Departamenti i Buxhetit, Ministria e Financave, Shqipëri.

Ky studim mund të ishte titulluar fare mirë “Roli i institucioneve në mirëqënen e Shqipërisë”. Autorët kanë paraqitur një numër pikash të forta dhe dobësish mbi një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në Shqipëri. Jam mëse dakord. Vendi ynë, falemiderit Zotit, duke pasur një pozitë gjeografike të favorshme dhe burime të pasura natyrore, ka nevojë vetëm për aftësi drejtuese dhe për angazhim nga ana e institucioneve, për të arritur një standard jetese më të lartë. Gjatë një periudhe mbi dhjetë vjet në tranzicion, lindën të dyja ndjenjat - e pesimizit dhe ajo e optimizmit - mbi të ardhmen. Megjithatë, disa lëvizje pozitive në ekonomi dhe në shoqëri krijuan një farë besimi se do të hidheshin bazat për një të zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.

Një nga përkufizimet më krijuese mbi zhvillimin e qëndrueshëm, mbështetet në tre forma të kapitalit: ekonomik, fizik dhe shoqëror/njerëzor. E parë në këtë këndvështrim, që përdoret dhe nga Banka Botërore, zhvillimi i qëndrueshëm përfshin kalimin e një rezerve të barabartë apo mundësish më të mëdha të kapitalit ekonomik,social dhe njerëzor tek brezat e ardhshëm. Ky përkufizim është një derivat i përkufizimit të Komisionit Brundland në vitin 1997 – “Zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes pa rrezikuar aftësinë e brezave të ardhshëm në përballimin e nevojave të tyre”. Kështu, roli i institucioneve në arritjen e këtij qëllimi është i një rëndësie kapitale.

Shqipëria, duke qenë një vend që gjatë këtyre viteve tranzicioni ka zbatuar politika në përputhje me teorinë “Marrëveshja e mirëkuptimit të Uashingtonit” kërkon një vëmendje më të madhe për sa i takon rolit të qeverisë në zhvillimin ekonomik. “Ajo çka i lidhët këto politika ishte besimi se qeveria kishte luajtur një rrol mbi aktiv në nxitjen e zhvillimit, duke marrë përsipër detyra më të përshtatshme për sektorin privat dhe duke abuzuar me kompetenca, që më mirë të mos ishin përdorur. Ndërhyrja e gjerë e qeverisë ishte jo vetëm e panevojshme në nxitjen e rritjes ekonomike, por ajo ishte pengesa kryesore në arritjen e saj”. Duke qenë pjesë e kësja filozofie, vitet e para të tranzicionit në Shqipëri drejt ekonomisë së tregut kanë qenë të shoqëruara me një besim keqkuptues “liri për të bërë gjithçka përvçe respektimit të rregullave”. Roli i qeverisë është keqkuptuar duke ndikuar kështu në cilësinë dhe efektivitetin e zhvillimit institucional, siç përmendin dhe autorët.

Ajo çka duket të dimë është nëse institucionet e tanishme në vendin tonë janë në atë fazë që do të ndihmonte zhvillimin ekonomik. Autorët kanë paraqitur një pamje të qartë mbi rolin e institucioneve në zhvillimin ekonomik, duke përdorur literaturë ekonomike dhe përvojën e vendeve të tjera me standarde jetese të ngjashme krahasuar me Shqipërinë.

Autorët, duke iu referuar Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Social dhe Ekonomik (NSSED), vënë re se ka shumë për të bërë për ngritjen e institucioneve në Shqipëri. Është për t'u përmendur fakti që Shqipëria ka identifikuar, me anë të një dokumeti të shkruar, dobësitet e saj dhe masat për t'u ndërmarrë.

Rëndësia e cilësisë së institucioneve në zhvillimin ekonomik mund të përmblidhet duke përdorur përkufizimin e Douglas North “Është pikërisht përzierja e rregullave formalë dhe joformal dhe karakteristikat përforcuese që i jepin formë strukturës nxitëse të një vendi”. NSSED, MTF dhe të tjera dokumente zhvillimi të ndërmarra nga institucionet shqiptare, janë shenjat e para për një rritje të qëndrueshme ekonomike. Aftësia e institucioneve për të hartuar politika për një periudhë afatmesme mund të shikohet si një masë e cilësisë së institucioneve.

Sic vërejnë dhe autorët, politika fiskale ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Lidhjet e saj me rritjen ekonomike kanë rrjedhur nga reforma e taksave dhe nga reformat mbi shpenzimet. Shpërndarja dhe cilësia e shpenzimeve të qeverisë do të jetë një rol i rëndësishëm në vazhdimësinë e rritjes ekonomike. Ngritia e nivelit të investimeve për sektorët me përparësi dhe ulja e nivelit të financimeve të deficitit buxhetor nga kursimet e individëve, do të sjellë mbrojtjen e rritjes ekonomike.

Për shkak të periudhës së shkurtër kohore, është e vështirë të masësh ndikimin e politikës fiskale në rritjen ekonomike në Shqipëri. Sipas teorisë së rritjes ekonomike, duket sikur ritmet e rritjes do të janë të kënaqshme në të ardhmen. Modeli Harrod-Domar parashtroi një lidhje konkrete dhe lineare ndërmjet investimeve dhe ritmeve të rritjes ekonomike në mbarë botën. Të dhënët mbi ritmet e rritjes së investimeve e mbështesin këtë lidhje; niveli i investimeve në Shqipëri do të vazhdojë të jetë më i lartë. Modeli neoklasik i rritjes Soloë-Sëan parashikoi se ritmet e rritjes varesin jo nga investimet, por nga ritmi i ndryshimeve teknologjike. Modeli Lucas (1998) argumentonte se kapitali njerëzor ishte faktor me rëndësi në përcaktimin e ritmeve të rritjes në mbarë botën, ndërsa Rebelo (1990) sugjeronte se në qoftë se vendet investonin në kapitalin njerëzor punë-shtues, të ardhurat mbi kapitalin fizik nuk do të pakësosheshin, duke lejuar kështu rritjen në vazhdimësi. Ky model ka theksuar rëndësinë e arsimimit.

Autorët vërejnë se dy faktorët kryesorë, që kanë ndikuar në rritjen ekonomike gjatë periudhës së tranzicionit, kanë qenë hyrja e madhe e të ardhurave nga emigrantët dhe rritja e të ardhurave të turizmit. Ajo çka autorët nuk paraqesin sa duhet, sipas mendimit tim, është nëse këta faktorë do të vazhdojnë të janë të rëndësishëm në mbrojtjen e rritjes ekonomike në të ardhmen. Po e mbyll me një analizë të shkurtër mbi faktin se pse situata e tanishme e turizmit nuk ka të ngjarë të garantojë një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe çfarë politikash nevojiten për të mbajtur drejtuesit kryesorë të rritjes ekonomike, sic është niveli i lartë i të ardhurave nga emigrantët.

Shqipëria përballet me konkurrencë rajonale përsë i përket turizmit – për shembull, me Greqinë, Kroacinë, Turqinë dhe Malin e Zi – të gjitha këto vende kanë një infrastruktur më të përparuar të turizmit dhe bukuri natyrore të ngjashme me Shqipërinë. Prandaj, turizmi nuk ka shumë të ngjarë të jetë një burim i rëndësishëm në rritjen ekonomike gjatë një periudhe afatshkurtër apo afatmesme. Një tjetër gjë interesante gjatë këtij viti është fakti se numri i turistëve shqiptarë që i kalojnë pushimet jashtë është rritur. Për mendimin tim, problemi kyç është mungesa e infrastrukturës, si në kapitalin fizik ashtu edhe në atë njerëzor. Roli i qeverisë duhet të jetë ai që ta përmirësojë këtë infrastrukturë

jo vetëm nëpërmjet nivelit të shpenzimeve publike por, githashtu, duke punuar ngushtë me sektorin privat në përmirësimin e në cilësinë e shërbimeve. Kjo do sigurojë një zhvillim më afatgjatë të turizmit.

Mbajtja e lartë e hyrjeve të të ardhurave nga emigrantët, si një nga faktorët më kryesorë të rritjes ekonomike, mendohet të jetë një problem për të ardhmen. Është e qartë se ky faktor ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe askush nuk dëshiron që ta humbasë këtë rol. Sjellja e brezave të ndryshëm në familjet në emigracion na tregon se, duke mos ndryshuar kushtet e tjera, niveli i të ardhurave nga emigrantët do të ulet në të ardhmen. Në qoftë se gjërat qëndrojnë po njësoj, ky përfundim tregon se zhvillimi ekonomik do të jetë në rënje. Pra, ç'mund të bëjmë për të mbajtur lart këtë nivel?

Duke qenë se emigrantët po krijojnë familjete tyre në vendet ku jetojnë e punojnë, niveli i të ardhurave prej tyre do të ulet. Ka dy mundësi për të shmangur këtë ndikim negativ; një është nxitja e emigrantëve për t'u kthyer në Shqipëri dhe përfitimi nga kapitalet e tyre finaciare, njerëzore dhe sociale, e dyta nxitja aktive e eksportimit të vazhdueshëm të kapitalit njerëzor. Sugjerimi im është se ne duhet të nxisim mundësinë e dytë dhe e para do të jetë rrjedhojë e saj. Ulja e papunësisë tek të rinjtë nëpërmjet emigracionit do të pakësojë problemet sociale brenda një periudhe të shkurtër, dhe duke qenë se këta individë do të kthehen me kapital njerëzor dhe social të përmirësuar, kjo do të ndihmojë zhvillimin ekonomik për një periudhë kohore afatgjatë. Ka rëndësi të kujtojmë faktin se eksportimi i kapitalit njerëzor, ashtu si dhe me mallra të tjerë, përballet me një konkurrencë në tregun botëror. Kështu, hapi i parë duhet të jetë krijimi i një politike arsimore të përshtatshme në Shqipëri për të rritur në maksimum vlerën e emigracionit në zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë. Ky përfundim nxjerr sërisht në pah rëndësinë e arsimimit.

Sistemi arsimor duket të jetë leva e Arkimedit në zhvillimin social-ekonomik. Një pikë që lidhet me këtë është: Në cilin nivel të arsimimit do të përqendrohem? Do t'i japim rëndësi arsimimit parauniversitar apo atij universitar? Eksperiencia irlandeze në nxitjen e arsimimit universitar dhe studimet pasuniversitare, është një shembull i mirë. Qeveria irlandeze siguroi një nivel arsimimi që përgatiti shumë nga qytetarët e saj të emigrionin me sukses në një treg pune të huaj dhe, gjithashtu, të kishin mundësi të përfitonin nga lehtësirat universitare dhe pasuniversitare të hauja. Ky ishte një faktor kyç që ndikon në rritjen ekonomike të atij vendi. Në Shqipëri, numri i studentëve që studiojnë jashtë dhe kthehen në vend është ende i vogël, por megjithatë është e rëndësishme të vihet re se gjatë vitit të fundit ecuria është përmirësuar.

Gjithashtu, është e rëndësishme të njihen pikat e dobëta dhe të forta të sistemit tonë arsimor dhe më pas të hartohen politikat e nevojshme. Do të ishte më përfitues përqëndrimi në arsimimin paraunivesitar ose në arsimimin profesional, si për shembull mësimi i gjuhëve të huaja apo specializime në fushën e turizmit. Kjo nënkupton që qeveria duhet të rrisë sasinë e parave drejt sektorit arsimor, por kërkohet zhvillimi i një strategji arsimimi me objektiva të qartë. Sistemi arsimor gjatë këtyre viteve është trajtuar me përparësi, por pavarësisht nga kjo, më shumë punë duhet bërë.

Një tregues i përparësisë në Programin Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2004-2006 dallohet: "Shpenzimet në arsim janë parashikuar të rriten nga 3.0 për qind të PBB në vitin

2004 në 3.1 për qind të PBB në vitin 2006. Mundësia për të rritur investimet në arsim pritet të jetë mjaft e kufizuar duke qënë se niveli i financimeve dhuruese për këtë sektor parashikohet të bjerë, meqë një numër projektesh kryesore kanë përfunduar.” Ky trajtim i sektorit arsimor shihet si një nga detyrat e përbushura theksuar në NSSED.

Programi buxhetor afatmesëm për vitet 2004-2006 vazhdon me:

“Strategjia e dhënë nga NSSED në pasjen si objektiv rritjet më të larta të programeve të pagave për shëndetësinë dhe arsimin do të vazhdojë. Pagat në këta sektorë rrjedhimisht duhet të rriten në mënyrë proporcionale më shpejt se në sektorët e tjera gjatë këtyre dy vjetëve. Në të gjitha shërbimet publike do të sigurohen fonde shtesë për pagesën e rindërtimit.”

Qëllimi i reformës drejtuese të shpenzimeve publike në Shqipëri është treplanësh: (i) arritura e qëndrueshmërisë fiskale – që është arritur me sukses; (ii) sigurimi i rishpërndarjes strategjike të burimeve – shpenzimi për arsimimin në përqindje të PBB-së, krahasuar me vendet e rajonit, është shumë i ulët. Kjo është në ndryshim, siç është ilustruar në dy paragrafët e mësipërm dhe tregon angazhimet e qeverisë në atë fushë; dhe (iii) rritja e rendimentit dhe efektshmërisë së shpenzimeve – kjo përbën sfidën e tanishme për Qeverinë Shqiptare. Ajo kërkon, për shembull, zhvillimin e një strategjie arsimore të qartë, që do të drejtojë çështje të tillë si rritja maksimale e përfitimeve që merr Shqipëria nga emigracioni si një burim rritjeje.

Kështu, është e qartë se qeveria po përqiqet të hartojë politika të sakta mbi sektorin e arsimit. Përveç politikave të qeverisë në vitet e fundit, brezi i ri po e shikon me shumë interes investimin në kapitalin njerëzor. Ky përfundim rrjedh nga numri në rritje i konkuruvesve në pranimet për në universitet, një numri i madh i studentëve që studiojnë jashtë dhe numri në rritje në universitetin tonë.

Në përfundim, autorët vërejnë se Shqipëria është ‘në vazhdimësi’ përsa i përket procesit të integrimit, por do të ishte interesante të ishin analizuar lidhjet e tij me zhvillimin ekonomik. Sigurisht që procesi i integrimit shihet me shumë interes nga Shqipëria, por në të njëtin kohë ai paraqet dhe shumë sfida. Sfida kryesore do të jetë krijimi i konkurrencës në tregun e integrimit.